



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 08 .

Prishtinë, më 30.01.2018 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i komisionit- Igor Simić, zëvendëskryetar i parë Xhelal Sveçla, anëtarët tjerë: Kujtim Shala, Fadil Beka, Jasmina Živkovic, Saša Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli dhe Mufera Serbica Sinik.

Munguan: Danush Ademi, Zoran Mojsilović dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuese nga OSBE-ja, Dhurata Kryeziu; përfaqësues nga EUSR/EU Pleurat Kurti: konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë e fushës- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simić, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rendi i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2017;**
- 3. Miratimi i raportit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Draft-Planit dhe Programit të punës së komisionit për vitin 2018;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2017;**

Kryetari, hodhi në votim procesberbalin, dhe i njëjti u miratua me shumicën e votave "për" dhe një "abstenim".

3. Miratimi i raportit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017;

Kryetari, kosnideron se në raportin e punës për vitin 2017, janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e komisionit në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësi nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, siq janë: shqyrtimi i raporteve me amandamente të Komisioneve funksionale për Projektligje, hartimi i raporteve me rekomandime për Kuvend, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, realizimi i vizitave në terren dhe rajonë.

Pasi nuk u dhanë propozime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë:

Përfundim

Në këtë mbledhje, Komisioni miratoi raportin e punës për sesionin vjeshtor 2017.

4. Shqyrtimi i Draft-Planit dhe Programit të punës së komisionit për vitin 2018;

Kryetari, në fjalën e tij tha se në bazë të Përfundimit të Kryesisë, ngarkohen komisionet parlamentar që mbi bazën e Programit Legjislativë të Qeverisë të Republikës së Kosovës për vitin 2018, të hartojë planin e punës periodike të komisionit për vitin 2018.

Ishte i mendimit se në Draft Planin e punës për vitin 2018, janë përfshirë të gjitha detyrimet e Komisionit në aspektin e mbrojtjes së të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve, si dhe angazhimet për shqyrtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve tjera, gjatë vitit 2018.

Me theks të veçant tha se Njësia mbështetëse e komisionit e ka përpubuar Draft Planin me propozime korrekte dhe kërkoi nga anëtarët të ofrojnë opinionet e tyre dhe të paraqesin propozimet eventuale për plotësimin e tij.

Albert Kinoli, mendon se mirë është i hartuar Draft -plani i punës. Ai propozoi që të rishqyrtohet i njëjti çdo tre muaj me qëllim të dhtejllohen çështjet me prioritet të veçant në kuadër të përgjegjësi të komisionit.

Në bazë të diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni miratoi Planin e Punës për vitin 2018, me arsye që të bëhet rishqyrtimi i planit dhe i rezultateve të punës për periudhën e parë, të dytë, dhe të tretën, dhe ndryshimet eventuale të planit.

Mbledhja përfundoi në ora 11.30

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simić